

**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"FABRIKA" shpk**

- 1) Sot, më 21/06/2024, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "FABRIKA" shpk.
- 2) Themeluesit e shoqërisë janë:

Z. Fabian Basha, atësia Faik, shtetas Shqiptar, identifikuar me ID me nr. I50302049R, i datëlindjes 02/03/1985 lindur në Tiranë dhe banues në Liqeni Thate, Nd. 15, H. 1; Farke, Selite, 1044, Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Z. Alban Kondi, atësia Muhamet, shtetas Shqiptar, identifikuar me ID me nr. I40604061I, i datëlindjes 04/06/1984 lindur në Berat dhe banues në Tiranë, Sulejman Delvina; Nd. 15; H.15; Ap.15; Njesia Administrative NR. 5; Njesia Bashkiake NR. 5; 1019; Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Z. Genc Osmani, atësia Musa, shtetas serb, identifikuar me ID me nr. 012940429, i datëlindjes 15/05/1988 lindur në Serbi, Rruga e Rinise, 021A, Presheve edhe banues në Presheve, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtëme.

**Neni 1
Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është "FABRIKA" shpk.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:
Objekti**

- 1) Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e mëposhtëm:

Produksione audiovizuale, prodhim, realizim dhe transmetim video, spote, dokumentare etj. Strategji marketingu, Fushata marketingu, Organizim evente. Import-eksport pajisje audio vizive. Shoqëria do të ushtrojë çdo aktivitet tjetër i cili është i lejuar nga legjislacioni shqiptar.

**Neni 3:
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Liqeni Thate, Nd. 15, H. 1; Farke, Selite, 1044, Tiranë.



- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Neni 5 **Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) Lekë dhe është i përbërë nga 3 (tre) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
- A. Ortakët themelues:
- **Fabian Basha**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 33,340 (tridhjetë e tre mijë e treqind e dyzete) Lekë, që përbën 33.34 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - **Alban Kondi**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 33,330 (tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë) Lekë, që përbën 33.33 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - **Genc Osmani**, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 33,330 (tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë) Lekë, që përbën 33.33 % të kapitalit themeltar të shoqërisë
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6 **Organi Vendimmarrës**

- 1) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 2) Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj

Neni 7 **Administratori**

- 1) Administratorë të shoqërisë emërohet :
- **Fabian Basha**, atësia Faik, shtetas Shqiptar, identifikuar me ID me nr. I50302049R, i datëlindjes 02/03/1985 lindur në Tirane dhe banues në „Liçeni Thate, Nd. 15, H. 1; Farke, Selite, 1044, Tirane, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 8 **Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë akt themelimit dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimit, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë

Neni 9
Mosmarrëveshjet

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

O R T A K E T
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“FABRIKA” shpk

Fabian Basha

FABIAN BASHA


Alban Kondi

Alban Kondi


Genc Osmani

Genc Osmani
